

20232624552

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J I

#### **I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA NË BANKËN EUROPIANE TË RINDËRTIMIT DHE TË ZHVILLIMIT SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR KORRIDORIN HEKURUDHOR VIII – FAZA 3, PJESA NGA KRIVA PALLANKA DERI NË KUFIRIN ME REPUBLIKËN E BULLGARISË**

##### Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Europiane të rindërtimit dhe të zhvillimit në vlerë prej 175.000.000 eurove, për financimin e projektit - Korridori hekurudhor VIII – Faza 3, pjesa nga Kriva Pallanka deri në kufirin me Republikën e Bullgarisë, që financohet pjesërisht edhe përmes Instrumentit të Ndihmës Paraaderuese – IPA të Bashkimit Europian.

##### Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit, të huas së cekur në neni 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen e huas për Korridorin hekurudhor VIII – Faza 3, pjesa nga Kriva Pallanka deri në kufirin me Republikën e Bullgarisë, e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Europiane të rindërtimit dhe të zhvillimit.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas së cekur në nenin 1 të këtij ligji do ta nënshkruajë ministri i Financave.

##### Neni 3

Huaja e cekur në nenin 1 të këtij ligji, jepet në dy transhe. Transheja e parë është në vlerë prej 74.000.000 eurove, ndërsa transheja e dytë është në vlerë prej 101.000.000 eurove.

Afati i shlyerjes së transhesë së parë të huas është 15 vjet, duke përfshirë periudhën grejs prej katër vjetësh. Transheja e parë e huas do të shlyhet në 22 këste gjysmëvjetore, më 20 prill dhe 20 tetor të çdo viti, duke filluar prej ditës së parë të përfundimit të vitit të katërt nga nënshkrimi i Marrëveshjes së huas.

Afati i shlyerjes së transhesë së dytë të huas është 15 vjet, duke përfshirë periudhën grejs prej katër vjetësh. Transheja e dytë e huas do të shlyhet në 22 këste gjysmëvjetore, më 20 prill dhe 20 tetor të çdo viti, duke filluar prej datës së parë nga dita e disponueshmërisë për shfrytëzimin e transhesë së dytë.

Norma e interesit është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR-i gjashtëmujor i rritur me margjinë prej 1%.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të rindërtimit dhe të zhvillimit provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të vlerës së transhesë së parë në afat prej shtatë ditëve nga dita kur transheja është efektive.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të rindërtimit dhe të zhvillimit provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të vlerës së transhesë së dytë në afat prej shtatë ditëve nga dita e disponueshmërisë për shfrytëzimin e transhesë së dytë.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Europiane të rindërtimit dhe të zhvillimit provizion për mjetet e patërhequra në vlerë prej 0.5% të huas në nivel vjetor.

Provizioni për mjetet e patërhequra të transhesë së parë do të fillojë të përlogaritet pas 60 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huas së cekur në nenin 2 të këtij ligji.

Provizioni për mjetet e patërhequra të transhesë së dytë do të fillojë të përlloritet pas 60 ditëve nga dita e disponueshmërisë për shfrytëzimin e transhesë së dytë.

#### Neni 4

Projektin e cekur në nenin 1 të këtij ligji, do ta zbatojnë Ministria e Financave – Sektori i Financimit Qendror dhe Lidhjes së Marrëveshjeve dhe Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” – Shkup.

#### Neni 5

Për realizimin e projektit të cekur në nenin 1 të këtij ligji, Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” – Shkup, do të nënshkruajë Marrëveshjen projektuese me Bankën Europiane të rindërtimit dhe të zhvillimit.

#### Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja e huas e nenit 2 të këtij ligji dhe Marrëveshja projektuese e nenit 5 të këtij ligji, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” – Shkup, do të nënshkruajnë marrëveshje të posaçme.

#### Neni 7

Republika e Maqedonisë së Veriut, huan e cekur në nenin 1 të këtij neni, do ta shlyejë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 8

Qarkullimi i realizuar i të mirave dhe/ose shërbimeve nga kontraktuesi i përzgjedhur ndaj Ndërmarrjes Publike të Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut”- Shkup, të destinuara për realizimin e Projektit të Korridorit hekurudhor VIII – Faza 3, pjesa nga Kriva Pallanka deri në kufirin me Republikën e Bullgarisë, të financuar me Marrëveshjen e huas së cekur në nenin 2 të këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e zbritjes së tatimit paraprak.

Për qarkullimin e realizuar të të mirave dhe/ose shërbimeve nga kontraktuesi i përzgjedhur ndaj Ndërmarrjes Publike të Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut”- Shkup, të destinuara për realizimin e projektit të Korridorit hekurudhor VIII – Faza 3, pjesa nga Kriva Pallanka deri në kufirin me Republikën e Bullgarisë, të financuar me Marrëveshjen e huas së cekur në nenin 2 të këtij ligji, për të cilën Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup, është debitorë tatimore, në pajtim me nenin 32 pika 4 e Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar ndërmarrja lirohet nga detyrimi për përlloraritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Për qarkullimin e realizuar të të mirave dhe/ose shërbimeve sa i përket lirimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas paragrafit 1 të këtij neni, realizuesi në faturë thekson se “tatimi mbi vlerën e shtuar nuk është përlloritur”, me ç’rast thekson bazën e lirimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar, përkatësisht titullin e projektit dhe titullin e Marrëveshjes së huas së cekur në nenin 2 të këtij ligji.

Importi i realizuar i të mirave/mallrave nga Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut”- Shkup, të destinuara për realizimin e Projektit të Korridorit hekurudhor VIII – Faza 3, pjesa nga Kriva Pallanka deri në kufirin me Republikën e Bullgarisë, të financuar nga Marrëveshja e huas së cekur në nenin 2 të këtij ligji është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrimet e importit, akciza e energjensave dhe tatimi i mjeteve motorike gjatë kohëzgjatjes së projektit në fjalë.

Ndërmarrja Publike e Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut”- Shkup, gjatë importit të të mirave/mallrave të liruar sipas paragrafit 4 të këtij neni, organit kompetent doganor duhet t'i dorëzojë detyrimisht kopje të Marrëveshjes së huas së cekur në nenin 2 të këtij ligji, si dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të destinuara për realizimin e projektit të Korridorit hekurudhor VIII – Faza 3, pjesa nga Kriva Pallanka deri në kufirin me Republikën e Bullgarisë, të financuar nga Marrëveshja e huas së cekur në nenin 2 të këtij ligji.

Qarkullimi i të mirave dhe/ose shërbimeve nga paragrafët 1 dhe 2 si dhe importi i të mirave/mallrave të paragrafit 4 i këtij neni, nuk mund ta tejkalojë vlerën nga neni 1 i këtij ligji.

#### Neni 9

Të mirat/mallrat që janë liruar nga pagesa e detyrimeve të importit në bazë të nenit 8 paragrafi 4 të këtij ligji, në afat prej tri viteve nga dita e importit nuk mund të tjetërsohen, t'i jepen për shfrytëzim ndonjë personi tjetër, të huazohen ose të shfrytëzohen ndryshe për qëllime të tjera dhe jo për ato për të cilat ishin liruar nga pagesa e detyrimeve të importit, para se të paguhen detyrimet e importit. Të mirat/mallrat nuk mund të jepen si kolateral, të huazohen ose të ofrohen si sigurim për detyrimet e tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para përfundimit të afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, ka për qëllim t'i shfrytëzojë të mirat/mallrat që janë liruar nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 8 paragrafi 4 të këtij ligji, për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat janë liruar nga pagesa e detyrimeve importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor në organin doganor.

Vlerën e borxhit doganor sipas paragrafit 2 të këtij neni, organi doganor e llogarit në bazë të elementëve për përcaktimin e detyrimeve që ishin të vlefshme gjatë parashtrimit të kërkesës për pagesën e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, vlera e borxhit doganor përlllogaritet në bazë të elementëve për përcaktimin e detyrimeve gjatë pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës mallrat lirohen nga pagesa e detyrimeve të importit.

#### Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.